

**Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë**

**Vështrim mbi tregjet**

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-prill 2019
- Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 31.03.2019
- Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 31.03.2019

**Zhvillime të tjera**

- Komisioni Evropian publikon Raportin për Shqipërinë, vlerëson arritjet e AMF-së
- AMF zhvillon konferencën e dytë kombëtare për edukimin financiar
- AMF pranë studentëve të Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër për edukimin financiar
- Banka Botërore vlerëson të kënaqshme, rezultatet e arritura nga AMF, në zbatim të projektit “Huaja për Politikën e Zhvillimit të Sektorit Financiar”
- Publikohet deklaratë përmbyllëse e ekipit të Misionit të Dytë të Monitorimit pas Programit të Fondit Monetar Ndërkombëtar në Shqipëri
- AMF rrit kapacitet njerëzore nëpërmjet trajnimeve

**Edukimi i Konsumatorit**

- Vite të rëndësishme përpara për IAIS (*pjesa e parë*)

**Botime Profesionale**

**Lajme Ndërkombëtare**

- Bullgari
- Kosovë
- Kroaci
- Mali i Zi

**Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin**

## Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi prezantoi më 30 maj, në seancë plenare, në Kuvendin e Shqipërisë, Raportin mbi aktivitetin e Autoritetit gjatë vitit 2018. Z. Koçi u ndal në zhvillimet dhe arritjet kryesore të vitit të kaluar, ndërsa përmendi disa nga sfidat me të cilat përballlet Autoriteti dhe tregjet nën mbikëqyrje.



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv Z. Ervin Koçi, gjatë raportimit në Kuvend mbi aktivitetin e Autoritetit për vitin 2018*

Z. Koçi u ndal te masat e marra nga Autoriteti për mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit, forcimin e rolit mbikëqyrës, rritjen e edukimit financiar, etj.

Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se Autoriteti ka plotësuar rekomandimet e lëna nga Kuvendi përmes rezolutës “Për veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017”. Z. Koçi u ndal te masat e marra nga Autoriteti për mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit, forcimin e rolit mbikëqyrës, rritjen e edukimit financiar, etj. Ai iu referua vlerësimeve të bëra për punën e Autoritetit në raportin e fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, si edhe rekomandimeve të institucioneve më të rëndësishme financiare ndërkombëtare.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, në lidhje me strategjinë e miratuar vitin e kaluar për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje 2018-2022, theksoi se sfida kryesore e Autoritetit do të jetë transformimi i tregjeve financiare jobankare nga tregjet më të brishta në rajon në një nga tregjet financiare më të konsoliduara në Ballkanin Perëndimor.


# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-prill 2019

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto për periudhën janar-prill 2019 arritën në mbi 5,300 milionë lekë, ose 8.3% më shumë se në periudhën janar-prill 2018. Gjatë periudhës janar-prill 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 376,717 me një rritje 5.63% krahasuar me periudhën janar-prill 2018. Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.17% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.09% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.73%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 40.78% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 59.22% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-prill 2019, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 1,940 milionë lekë, ose 6.68% më shumë se në periudhën janar-prill 2018.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-prill 2019




Të ardhurat nga primet e shkruara bruto për periudhën janar-prill kapën vlerën mbi 5,300 milionë lekë, ose 8.3% më shumë se në periudhën janar-prill 2018.

## Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 31.03.2019

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2019, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.03.2019 tregon një total asetesh neto prej 2,423.91 milionë lekë (19.34 milionë euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit në Bankën e Shqipërisë 31.03.2019, 1 euro=125.34 lekë) dhe me një rritje prej 134.81 milionë lekë (5.89%) krahasuar me 31.12.2018. Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 31.03.2019 është 26,143 anëtarë duke shënuar rritje prej 3.34% krahasuar me 31.12.2018.

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në Fondet e Pensioneve, 31.03.2019 (në %)



Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 31.03.2019 është 26,143 anëtarë duke shënuar rritje prej 3.34% krahasuar me 31.12.2018.

### Tregues të Fondeve të Pensioneve

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)
Periudha	31.12.'18	31.03.'19	31.12.'18-31.03'19
Asetet neto të FP	2,289.10	2,423.91	5.89


### Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas Fondeve të Pensioneve, 31.03.2019

Fond Pensioni	Numri i anëtarëve në FP	Asete Neto (mln. lekë)
SIGAL	7,281	1,127.56
RAIFFEISEN	2,956	659.09
CREDINS PENSION	15,906	637.27
TOTAL	26,143	2,423.91

## Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 31.03.2019

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2019, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre pesë fonde investimi. Fondi i investimeve “Raiffeisen Prestigj”, fondi i investimeve “Raiffeisen Invest Euro” dhe fondi i investimeve “Raiffeisen Vizion” administrohen nga shoqëria “Raiffeisen Invest”. Fondi i investimeve “Credins Premium” administrohet nga shoqëria administruese “Credins Invest”, ndërkohë që fondi “WVP Top Invest” është nën administrim nga shoqëria “WVP Fund Management Tirana sh.a”.

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e investimeve, 31.03.2019 (në %)



Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 31.03.2019, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti rreth 69.48 miliardë lekë me një rritje prej 2.47 miliardë lekë ose 3.68%, krahasuar me 31.12.2018. E shprehur në euro, totali i aseteve neto është 554 milionë euro, (sipas kursit zyrtar të këmbimit në Bankën e Shqipërisë 31.03.2019, 1 euro=125.34 lekë).

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 64.25% të aseteve të fondeve, me një rritje prej 5.41% krahasuar me 31.12.2019. Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 31.03.2019 është 30,226 me një rritje prej 2.74% krahasuar me 31.12.2018.

### Tregues të Fondeve të Investimeve

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)
Periudha	31.12.'18	31.03.'19	31.12.'18-31.03'19
Asetet neto të FI	67,009	69,477	3.68

### Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas Fondeve të Investimeve, 31.03.2019

Fond Investimi	Numri i anëtarëve në FI	Asete Neto (mln. lekë)
Raiffeisen PRESTIGJ	22,776	47,211
Raiffeisen EURO	3,311	10,125
Raiffeisen VIZION	3,133	9,170
Credins PREMIUM	939	2,879
WVP Top Invest	67	93
TOTAL	30,226	69,477

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 31.03.2019, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti rreth 69.48 miliardë lekë me një rritje prej 2.47 miliardë lekë ose 3.68%, krahasuar me 31.12.2018.

# ZHVILLIME TË TJERA

## Komisioni Evropian publikon Raportin për Shqipërinë, vlerëson arritjet e AMF-së



Komisioni Evropian publikoi “Paketën e Zgjerimit 2019”, duke vlerësuar progresin e bërë nga Shqipëria dhe duke rekomanduar hapjen e negociatave. Vendimi përfundimtar pritet të merret nga vendet anëtare në fund të qershorit.

Paketa përmban raportet me vlerësime të detajuara të gjendjes në çdo vend kandidat dhe potencialisht kandidat, për atë që është arritur gjatë vitit 2018 dhe përcakton udhëzimet dhe prioritetet për reformat në të ardhmen.

Raporti për Shqipërinë, në Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare” vlerëson ecurinë e vendit në shërbimet financiare. Raporti vlerëson pozitivisht miratimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Strategjisë 2018-2022 për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrjen e saj, si edhe zbatimin e Strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit dhe investitorit për tregjet nën mbikëqyrje.

Në fushën e sigurimeve, Raporti thekson nevojën për miratimin e amendimeve në ligjin për sigurimin e detyrueshëm motorik, ndërsa vlerësohet se janë tashmë të hartuara aktet nënligjore për zbatimin e direktivave të BE-së për *Solvency I* dhe *Solvency II*.

Raporti vlerëson si një hap pozitiv krijimin e një Depozitari Qendror të Letrave me Vlerë (AFISAR).

Sa i përket tregut të letrave me vlerë dhe shërbimeve të investimit, në raport vlerësohen miratimet që Autoriteti ka bërë në kërkesat e tij rregullative dhe mbikëqyrëse në forcimin e kërkesave për likuiditetin për fondet e investimeve.

Raporti vlerëson pozitivisht miratimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Strategjisë 2018-2022 për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrjen e saj, si edhe zbatimin e Strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit dhe investitorit për tregjet nën mbikëqyrje.



## AMF zhvillon konferencën e dytë kombëtare për edukimin financiar

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi më 24 maj 2019, Konferencën e dytë Kombëtare “Edukimi Financiar” me fokus kryesor studentët, të cilët shpалosën punime të ndryshme në lidhje me tregjet nën mbikëqyrje dhe rëndësinë e edukimit financiar për zhvillimin e tyre.



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, gjatë zhvillimit të konferencës*

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, u ndal te rëndësia e edukimit financiar për mbrojtjen e konsumatorëve dhe investitorëve. Ai theksoi se Autoriteti përveç angazhimit të nisur me fushata informuese në universitete, ka shkuar edhe më tej me një nismë për praktikat mësimore të studentëve.

“Autoriteti ka koordinuar për herë të parë përgjatë këtij viti praktikat profesionale të rreth 300 studentëve, me shpërndarjen e tyre pranë shoqërive të tregjeve që ne mbikëqyrim. Kjo është një nismë me përfitim reciprok, ku në njërin anë studentët aftësohen dhe njihen nga afër me proceset e punës, ndërsa në anën tjetër, shoqëritë e kanë më të lehtë për të identifikuar dhe rekrutuar profesionistët e së ardhmes. Aktualisht, në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare po zhvillojnë praktikën mësimore 9 studentë, të cilët përgjatë një muaji marrin informacion të plotë dhe të gjithanshëm në lidhje me të gjitha proceset e punës në Autoritet,” u shpreh Z. Koçi.

Konferenca u përshëndet edhe nga Zëvendësministri i Arsimit, Z. Redi Shtino, i cili theksoi se Ministria e Arsimit i ka kushtuar vëmendje të posaçme edukimit financiar dhe përfshirjes sa më të madhe të të rinjve nëpërmjet nismave konkrete. Ai përmendi përfshirjen e lëndës së ekonomisë si lëndë bazë në kurrikulën e klasës së 12-të në shkollat e mesme.

Të pranishëm në konferencë ishin dhe Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë, Z. Elton Haxhi dhe përfaqësues nga Banka e Shqipërisë.

Autoriteti i  
Mbikëqyrjes  
Financiare organizoi  
më 24 maj 2019,  
Konferencën e dytë  
Kombëtare “Edukimi  
Financiar” me fokus  
kryesor studentët, të  
cilët shpалosën  
punime të ndryshme  
në lidhje me tregjet  
nën mbikëqyrje dhe  
rëndësinë e edukimit  
financiar për  
zhvillimin e tyre.

Të gjithë të pranishmit e vlerësuan këtë nismë të Autoritetit dhe theksuan gadishmërinë për zgjerimin e edukimit financiar në nivel kombëtar, si një domosdoshmëri në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Tematikat e trajtuara në punimet e studentëve, të udhëhequr edhe nga pedagogët e tyre, përfshinin mes të tjerave:

- Tregu i sigurimeve, dixhitalizimi, çfarë e pengon zhvillimin e mëtejshëm të tij;
- Kushtet e kontratave të sigurimit;
- Bursat, niveli i zhvillimit të tyre në Shqipëri;
- Faktorët që ndikojnë mbi perceptimin e produkteve vullnetare;
- Aftësimi financiar të rinjtë shqiptarë;
- Fondet e investimeve si një mundësi alternative investimi;
- Roli i fondeve të pensionit në tregun financiar, etj.

Risi e kësaj konference ishte edhe formati i prezantimit të punimeve dhe mënyra interaktive e realizuar nga studentët. Në përfundim të konferencës, Autoriteti dhe shoqatat e tregjeve nën mbikëqyrje, Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë, Shoqata e Siguruesve të Jetës, Pensioneve Private dhe Fondeve të Investimit, si dhe Shoqata e Tregtimit të Titujve në Shqipëri vlerësuan punimet më të mira.

Me çmimin e parë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u vlerësua punimi “Aftësimi financiar dhe rëndësia e tij”, i realizuar nga katër studentë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës.

Vlerësimet lidheshin me kontrata punësimi në shoqëritë që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrje, mundësinë e praktikave profesionale apo dhurimin e pajisjeve dixhitale për studentët. AMF e ka kthyer tashmë këtë konferencë me studentët në një aktivitet të përvitshëm, duke i shërbyer edukimit financiar dhe përfshirjes së të rinjve në tregjet nën mbikëqyrje.

Me çmimin e parë nga  
Autoriteti i Mbikëqyrjes  
Financiare u vlerësua  
punimi “Aftësimi  
financiar dhe rëndësia  
e tij”, i realizuar nga  
katër studentë të  
Fakultetit Ekonomik të  
Universitetit të  
Tiranës.



## AMF, pranë studentëve të Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër për rritjen e edukimit financiar

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më datë 6 maj, një leksion të hapur me studentë të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit Juridik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të “Strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet financiare nën mbikëqyrje”, me qëllim kryesor rritjen e edukimit financiar të studentëve.



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe rektori i Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Prof. Dr. Adem Bekteshi gjatë nënshkrimit të marrëveshjes*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më datë 6 maj, një leksion të hapur me studentë të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit Juridik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër.

Aktiviteti i parapriu nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mes Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe rektori i Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Prof. Dr. Adem Bekteshi. Në fjalën e mbajtur, Z. Koçi theksoi se edukimi financiar për tregjet nën mbikëqyrje është një nga prioritetet e punës së Autoritetit. Bashkëpunimi i vendosur nëpërmjet marrëveshjes së nënshkruar me Universitetin “Luigj Gurakuqi” është një mundësi shumë e mirë për të gjithë studentët për t’u përfshirë në nismat e Autoritetit, për zhvillimin e internshipeve pranë AMF ose në shoqëritë që operojnë në tregjet financiare nën mbikëqyrje.

Rektori i Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Z. Bekteshi deklaroi se marrëveshja e nënshkruar mes dy institucioneve do të jetë me përfitim reciprok. Ajo do t’i shërbejë studentëve të universitetit, duke i asistuar me materiale të ndryshme, si edhe do të jetë një bazë e mirë për thellimin e bashkëpunimit me qëllim zgjerimin e njohurive financiare të studentëve dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës.

Në orën e hapur të leksionit, studentët u njohën me rolin dhe funksionet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si një institucion i pavarur. Gjithashtu studentët u anketuan nga Autoriteti për matjen e njohurive financiare për tregjet nën mbikëqyrje.

## **Banka Botërore vlerëson të kënaqshme, rezultatet e arritura nga AMF, në zbatim të projektit “Huaja për Politikën e Zhvillimit të Sektorit Financiar”**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përfundoi zbatimin e projektit “Huaja për Politikën e Zhvillimit të Sektorit Financiar” të mbështetur nga Banka Botërore. AMF ishte përfituese në kolonën e tretë të këtij projekti “Forcimi i rregullimit dhe mbikëqyrjes së fondeve të investimeve”. Raporti i ekipit të Bankës Botërore vlerëson se AMF i ka realizuar gjithë treguesit e performancës së projektit dhe i vlerëson ato në mënyrë të kënaqshme.

Përfshirja e AMF-së në këtë projekt solli, si përmirësime të kuadrit ligjor rregullues, për t’ju përshtatur zhvillimeve të vrullshme në tregun e kapitalit në vend, ashtu edhe forcimin e rolit mbikëqyrës të Autoritetit. Në kuadër të projektit, u miratua në Kuvendin e Shqipërisë ndryshimi i legjislacionin përkatës.

Bordi i AMF-së miratoi rregulloren “Për administrimin e riskut të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive” si edhe rregulloren “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimit”. Në shkurt 2018 rregullorja e likuiditetit, e miratuar më herët, u plotësua me të tjera kritere duke rritur limitin e aseteve likuide që duhet të mbajnë fondet e investimeve për t’ju përgjigjur kërkesave të mundshme të investitorëve.

Eksperienca e fituar në zbatimin e projektit dhe masat e ndërmarra për minimumin e likuiditetit të kërkuar nga fondet e investimeve, rritën më shumë mbrojtjen e investitorëve, duke fuqizuar rolin mbikëqyrës të Autoritetit. Mbrojtja e konsumatorit dhe investitorit në sektorin financiar jobankar, është vendosur nga AMF, si një ndër prioritetet dhe objektivat e rëndësishme të punës në vazhdimësi.

Raporti i ekipit të Bankës Botërore, për kolonën e tretë ku përfshihej AMF, nënvizon se të gjithë indikatorët kryesorë të performancës u arritën. Ai i vlerëson të kënaqshme rezultatet e arritura në këtë projekt, duke theksuar edhe përkushtimin e lartë për të arritur përmirësime të qëndrueshme në stabilitetin financiar.

Raporti i ekipit të Bankës Botërore vlerëson se AMF i ka realizuar gjithë treguesit e performancës së projektit dhe i vlerëson ato në mënyrë të kënaqshme.



## Deklaratë përmbyllëse e ekipit të Misionit të Dytë të Monitorimit pas Programit të Fondit Monetar Ndërkombëtar në Shqipëri

Në përmbyllje të misionit të dytë të monitorimit delegacioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar në Shqipëri nënvizon se perspektiva ekonomike është përgjithësisht e favorshme. Rritja pritet të moderohet në 2019, por do të vijojë të jetë afër nivelit 4 për qind në periudhën afatmesme.

Deklarata e publikuar thekson ndër të tjera se "...në periudhën afatmesme, veprimtaria pritet të nxitet nga një përshpejtim i rritjes në BE, rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës, fuqizimi gradual i eksporteve përfshirë turizmin dhe investimet e nevojshme për ta mbyllur hendekun e madh infrastrukturor në Shqipëri. Megjithatë, zhvillimi i qëndrueshëm varet edhe nga përmirësimet në qeverisjen ekonomike, përfshirë në fushën e shtetit ligjor dhe në luftën kundër korrupsionit."

## AMF rrit komunikimin me publikun në funksion të mbrojtjes së konsumatorit



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka rritur në mënyrë të ndjeshme komunikimin me publikun duke u përqendruar në shqyrtimin dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve. AMF mbetet e angazhuar për të garantuar mbrojtjen e konsumatorëve dhe investitorëve, rritjen e transparencës dhe nivelit të edukimit financiar për tregjet nën mbikëqyrje.

Krijimi dhe vënia në funksion e platformës së raportimit të ankesave online për të gjitha tregjet nën mbikëqyrje nga muaji shkurt 2019 ka rritur edhe më tej komunikimin dhe besueshmërinë e qytetarëve ndaj Autoritetit.

Krijimi dhe vënia në funksion e platformës së raportimit të ankesave online për të gjitha tregjet nën mbikëqyrje nga muaji shkurt 2019 ka rritur edhe më tej komunikimin dhe besueshmërinë e qytetarëve ndaj Autoritetit.

—○○○—  
Në mbrojtje të  
investitorëve, Autoriteti  
ka publikuar disa  
paralajmërime në lidhje  
me rrezikun e disa  
produkteve financiare  
dhe aktivitetit të  
shoqërive të  
palicencuara në tregun  
e kapitalit.  
—○○○—

Vitin e kaluar, në Autoritet u depozituan në total 162 ankesa, të cilat lidhen me kërkesat për dëmshpërblim që rrjedhin drejtpërdrejt nga kontratat e sigurimit, të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit apo me ankesa ndaj operatorëve të tregut të fondeve të investimeve dhe të pensioneve vullnetare.

Pjesa më e madhe e ankesave për tregun e sigurimeve lidhet me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit dhe kanë të bëjnë kryesisht me vlerësimin e dëmit. Ndërkohë, janë depozituar 80 ankesa në lidhje me pagesat e dëmshpërblimit, objekt i Fondit të Kompensimit. Në përfundim, rreth 58% e ankesave të konsumatorit janë zgjidhur pas ndërhyrjes së Autoritetit.

Rastet e ankesave lidhur me fondet e pensioneve vullnetare lidhen me interpretimin dhe procedurën e zbatueshme në rastet e largimit nga fondi. Pas diskutimeve me subjektet e mbikëqyrura, çështja është zgjidhur në favor të palës që ka paraqitur ankimin.

Ankesat për fondet e investimit janë bërë kryesisht në lidhje me komisionet e aplikuara nga depozitari bankë. Autoriteti ka realizuar një inspektim pas ankesave të marra dhe në një rast ka urdhëruar depozitarin të mos aplikojë komisione shtesë.

Në mbrojtje të investitorëve, Autoriteti ka publikuar disa paralajmërime në lidhje me rrezikun e disa produkteve financiare dhe aktivitetit të shoqërive të palicencuara në tregun e kapitalit. Mbrojtja e konsumatorit dhe investitorit u realizua edhe përmes aktiviteteve të shumta për rritjen e edukimit financiar për publikun, apo broshurave informative për tregjet nën mbikëqyrje.

### **Takimi i 44-të Vjetor i IOSCO-s vendos edhe drejtimit prioritarë të punës gjatë 2019**

Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Komisionit të Letrave me Vlerë (IOSCO) u mbledhën në Takimin e 44-të Vjetor të Organizatës, në Sydney i cili u zhvillua nga 13 deri më 15 Maj. Aty u diskutuan çështjet prioritarë me të cilat ballafaqohen sot rregullatorët dhe mbikëqyrësit e tregut të letrave me vlerë. Takimi, i cili u organizua nga Komisioni Australian i Letrave me Vlerë dhe Investimeve (ASIC) dhe morën pjesë rreth 350 anëtarë të IOSCO-s. Takimi vjetor përfshinte takime të Bordit të IOSCO-s, Komitetit të Rritjes dhe Emergjencave të IOSCO-s (GEM), katër Komiteteve Rajonale dhe Komitetit Konsultativ të Anëtarëve (AMCC).

Pjesëmarrësit në panele dhe seancat plenare diskutuan mjaft tematika mbi aspektet e ndryshme të punës së prioriteteve të IOSCO-s, duke përfshirë kriptimin e aseteve, Fintech, qëndrueshmërinë, privatësinë e të dhënave, fragmentimin e tregut, menaxhimin e aseteve dhe digjitalizimin.

Në takim, Bordi i IOSCO-s shqyrtoi hapat e ardhshëm për këto çështje të rëndësishme prioritare, të cilat janë në përputhje me planin e punës së IOSCO-s për vitin 2019.

### **Kripto-Asetet**

Anëtarët e Bordit ranë dakord, që në përgjigje të një kërkesë të G20, të publikonin një raport konsultimi mbi platformat e tregtimit të kripto-aseteve. Materiali synon të ndihmojë anëtarët e IOSCO-s në vlerësimin e sfidave serioze të mbrojtjes së investitorëve në lidhje me këto platforma tregtare.

Më 6 maj, IOSCO prezantoi një portal për kërcënime dixhitale që po lindin (*Emerging Digital Threats EDT*). Portali i mundëson anëtarëve të IOSCO-s të ndajnë informacione lidhur me kërcënimet dixhitale që po lindin, duke përfshirë ato që lidhen me kripto-asetet. IOSCO gjithashtu do të hartojë materiale për të ndihmuar rregullatorët në edukimin e investitorëve, në shitjen me pakicë në lidhje me kripto-asetet.

Portali i mundëson anëtarëve të IOSCO-s të ndajnë informacione lidhur me kërcënimet dixhitale që po lindin, duke përfshirë ato që lidhen me kripto-asetet.

### **Fragmentimi i tregut**

Bordi ra dakord të publikojë një raport të IOSCO-s mbi fragmentimin e tregut dhe rregullimin ndërkuftar, në përgjigje të një kërkesë të G20, e cila analizon se si disa tregje financiare mund të kenë përjetuar copëzimin tërësisht, ose pjesërisht, për shkak të rregullimit. Bordi i IOSCO-s do të vijojë bashkëpunimin me Bordin e Stabilitetit Financiar për këtë çështje.

### **Menaxhimi i aseteve**

Bordi diskutoi konsultimet publike të IOSCO-s mbi propozimet për të matur nivelin e huasë kapitale në fondet e investimeve dhe për të mbledhur të dhëna bazuar në mënyrën e zhvillimit. Ky proces konsultimi është pjesë e punës së bërë nga IOSCO për rekomandimet e Bordit të Stabilitetit Financiar për të adresuar dobësitë e mundshme strukturore në menaxhimin e aseteve.

### **Kërkesat e marzhit**

Bordi analizoi çështjet rreth fazës përfundimtare të zbatimit të kërkesave të marzhit BCBS-IOSCO për derivativët e trajtuar në mënyrë jo të centralizuar.

### **Fintech Network**

Bordi diskutoi punën e rrjetit IOSCO Fintech, i themeluar në maj 2018, për të lehtësuar shkëmbimin e njohurive dhe përvojave midis anëtarëve të IOSCO-s.

Bordi diskutoi hapat e ardhshëm për katër rrjedhat e punës: teknologjia e shpërndarjes, etika në inteligjencën artificiale, Regtech dhe inkurajimi i inovacionit. Anëtarët gjithashtu diskutuan se si IOSCO mund të ndihmonte tregjet në zhvillim me çështjet e Fintech.

### **Financat e Qëndrueshme**

Bordi diskutoi punën e rjetit të qëndrueshëm financiar të IOSCO-s, i krijuar vitin e kaluar për t'u përqendruar në rolin e rregullatorëve në financimin e qëndrueshëm dhe iniciativat ndërkombëtare të marra nga organizatat e tjera. Bordi vuri në dukje një raport mbi financimin e qëndrueshëm në tregjet në zhvillim që Komiteti GEM do të publikojë.

### **Mbrojtja e të Dhënave**

Anëtarët e Bordit diskutuan hapat e tjerë për një Marrëveshje Administrative (AA) në lidhje me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Evropiane (GDPR), e cila u miratua nga Bordi IOSCO-s, Bordi i Mbikëqyrjes së Autoritetit Evropian të Letrave me Vlerë dhe Tregjeve (ESMA), Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave. Kjo përfshinte udhëzimin e anëtarëve për nënshkrimin e marrëveshjes. Kjo lehtëson bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe shkëmbimin e informatave mbikëqyrëse në kuadrin e marrëveshjeve ekzistuese për shkëmbimin e informacionit ose memorandumëve, duke përfshirë Memorandumin e Mirëkuptimit Shumëpalësh të IOSCO (MMoU) dhe Enhanced-MMoU duke siguruar mbrojtje për transferimin e të dhënave personale në mes të Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE) dhe jo anëtarë të ZEE.

Bordi vuri në dukje se disa anëtarë të IOSCO-s kanë nënshkruar AA (aktualisht 16) dhe inkurajojnë anëtarët e tjerë të marrin në konsideratë nënshkrimin e saj.

### **Task Force Kibernetike**

Bordi ra dakord të publikojë një raport të grupit të punës që shqyrton se si anëtarët e IOSCO-s po aplikojnë standarde ekzistuese kibernetike ose udhëzime në regjimet e tyre rregullatore përkatëse dhe identifikon boshllëqet e mundshme në zbatimin e këtyre standardeve që mund të kenë nevojë të adresohen.

### **Shpërndarja me pakicë dhe dixhitalizimi**

Bordi shqyrtoi punën e IOSCO-s lidhur me shpërndarjen me pakicë dhe dixhitalizimin, i cili shqyrton se si firmat përdorin modele të shpërndarjes dixhitale me karakteristika të tilla si reklamimi *online* dhe marketingu ndërkufitar, duke arritur potencialisht edhe të shmangin rregullat lokale dhe të synojnë konsumatorët vulnerabël me oferta financiare komplekse, me produkte me rrezik të lartë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është anëtar me të drejta të plota i IOSCO-s që prej vitit 1998.



## Seminar mbi provigjonimin e dëmeve në klasat e Jo-Jetës

Akademia Aktuariale Evropiane zhvilloi në datat 27-28 maj 2019 në Pragë, seminarin mbi provigjonimin e dëmeve në klasat e Jo-Jetës. Në të morën pjesë aktuarë dhe ekspertë të tregut të sigurimeve nga gjashtëmbëdhjetë vende të ndryshme të Botës.



Temat kryesore që u trajtuan kishin të bënin me krijimin dhe aplikimin e metodave parashikuese, të cilët mund të përdoren në shumë aktivitete të sigurimit të Jo-Jetës. U trajtuan metodat bazë si *Chain – Ladder* dhe *BF*, karakteristikat e tyre, avatazhet dhe disavantazhet. Në vijim me përfitim të njohurive të nevojshme, u trajtuan metodat: *Benktande*, *Buhlmann-Straub* dhe *Hesselager-Witting*, metoda të reja për tregun e sigurimeve të Shqipërisë.

Si përfundim, bazuar në të dhënat e tregut të sigurimeve, u trajtuan shembuj praktik në lidhje me metodat parashikuese, të cilët analizonin të gjitha hapat që ndiqen në zbatimin e këtyre metodave. Duke filluar nga mbledhja e të dhënave, përpunimi i tyre, krijimi i modelit, vlerësimi dhe zhvillimi i tij.

## Zhvillohet Konferenca “Fintech” për rregullatorët financiarë

Qendra Këshillimore për Sektorin Financiar (FinSAC) zhvilloi në Vjenë në datat 22-23 maj konferencën “Fintech”. Konferenca u organizua me mbështetjen e Bankës Botërore.

Sistemet financiare në mbarë botën kanë pësuar ndryshime të shpejta vitet e fundit për shkak të teknologjisë, duke bërë gjithnjë e më shumë të përdorshme fjalët e reja si “Fintech”. Rregullatorët dhe mbikëqyrësit e sistemeve financiare duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të njohin teknologjitë kryesore që nxisin zhvillimin e shërbimeve financiare. Konferenca synoi të zbulojë disa fusha kyçe të përshtatshme me audiencën e rregullatorëve financiar, në një nivel praktik.

Pjesëmarrësit në këtë konferencë, si rregullatorët, mbikëqyrësit dhe drejtuesit e bankave qendrore, ashtu edhe donatorët, klientët dhe partnerët e tjerë në këtë fushë fituan një kuptim më të thellë të Fintech.

—○○○—  
Sistemet financiare në mbarë botën kanë pësuar ndryshime të shpejta vitet e fundit për shkak të teknologjisë, duke bërë gjithnjë e më shumë të përdorshme fjalët e reja si “Fintech”.  
—○○○—

Konferenca u përqendrua në temat më të diskutuara për *Fintech* për rregullatorët financiarë, mbikëqyrësit dhe përfaqësuesit nga bankat qendrorë. Disa nga këto tema lidheshin me:

- Rregullatorët dhe përgjigjet e mbikëqyrjes ndaj *Fintech*;
- *Suptech* dhe *Regtech*;
- Rreziku operacional që sjell *Fintech*;
- Teknologjia e Shpërndarjes *Ledger* dhe krypto-asetet;
- Evolucionin e kredisë konsumatore.

Temat u moderuan në mënyrë të tillë që për secilën nga fushat të paraqiteshin raste reale të jetës dhe/ose të jepeshin demonstrime të produkteve ose aplikacioneve të përdorshme. Gjithashtu u diskutuan edhe prirjet, mundësitë dhe sfidat për këtë audiencë të veçantë.

Konferenca shërbeu edhe si një mundësi për të diskutuar, shkëmbyer eksperiencat dhe krijuar marrëdhënie midis pjesëmarrësve për eksperiencat midis autoriteteve homologe. Si pjesë e konferencës, u hartuan dhe shpërndanë një seri dokumentesh të shkurtër të politikave që adresojnë këto tema lidhur me *Fintech*.

## Zhvillohet mbledhja e Forumit të 8-të Vjetor të Pensioneve

Këshilli i Pensioneve Botërore, (World Pensions Council, WPC) në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Fondeve të Pensioneve dhe Fondeve të Sigurimeve Shoqërore zhvilluan në datat 23-24 maj 2019 në Bruksel, Belgjikë, mbledhjen e Forumit të 8-të Vjetor të Pensioneve.

Forumit të 8 Vjetor të Pensioneve u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga fonde të ndryshme pensionesh, bankat qendrore dhe rregullatorë nga vende të ndryshme të botës. Në këtë Forum u diskutuan çështje që lidhen me investimin e aseteve, strategjitë e dezinjimit të skemave të pensioneve dhe të manaxhimit të tyre, përfshirë ESG, transferimin e riskut të jetëgjatësisë, etj.

Gjatë këtij forumi u vu theksi në tendencat e reja dhe në përshtatjen me mënyrat bashkëkohore të manaxhimit të aseteve financiare. Kjo do të bëjë që manaxherët e aseteve të përshtaten me këtë ndryshim kushtesh, duke menduar sesi ata do të mbrojnë portofolet e tyre dhe të zgjedhin stilet më të përshtatshme të manaxhimit.

Forumi i 8 Vjetor i Pensioneve u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga fonde të ndryshme pensionesh, bankat qendrore dhe rregullatorë nga vende të ndryshme të botës.

Nga diskutimet e përfaqësuesve të ndryshëm të menaxhimit të aseteve në botë u diskutua për mënyrën sesi ata mendonin të blinin mbrojtje për portofolet e tyre, të tilla si p.sh në formën e derivativëve. Kjo masë mbrojtëse do të bënte të mundur vazhdimin e investimeve në asetet me rrezik.

Gjithashtu, në këtë aktivitet u diskutua për përfitimet kryesore që kanë fondet e pensioneve *cross-border* me shumë anëtarë të tilla si plotësisht operacionale dhe në përputhje me bazën ligjore, zgjidhje gjithëpërfshirëse, ekonomi të shkallës, monitorim më i mirë dhe rreziqe më të ulëta, etj.

### **Takimi i 17-të i Iniciativës së Mbikëqyrjes së Sigurimeve për Evropën Qendrore, Lindore dhe Jug-Lindore**

Në datën 29 maj 2019 u zhvillua në Shkup takimi i 17-të i Iniciativës së Mbikëqyrjes së Sigurimeve për Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE - Central, Eastern and South Eastern European Insurance Supervision Initiative). Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga vende të ndryshme të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Temat e trajtuara në takim kishin të bënin me:

- Eksperiencën e Kroacisë mbi zbatimin e rregullave për kanalet e shpërndarjes të kërkuara nga Direktiva e Bashkimit Evropian 2016/97, e cila vendos rregullat rreth pranimit dhe ndjekjes së kanaleve të shpërndarjes në veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit;
- Qasjen e biznesit, përsa i përket procesit të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim të ardhura nga sigurimet motorike;
- Rrezikun e aktivitetit të parandalimit dhe pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në sigurime;
- Sfidat e Rregullatorit në veprimtarinë e risigurimeve pas hyrjes në fuqi të *Solvency*.

Qëllimi i takimit ishte jo vetëm prezantimi i temave të ndryshme të vendeve pjesëmarrëse, por edhe nxitja e bashkëbisedimit dhe ndarjes së eksperiencave të ndryshme ndërmjet përfaqësuesve të pranishëm.

Qëllimi i takimit ishte jo vetëm prezantimi i temave të ndryshme të vendeve pjesëmarrëse, por edhe nxitja e bashkëbisedimit dhe ndarjes së eksperiencave të ndryshme ndërmjet përfaqësuesve të pranishëm.

## Programi i asistencës teknike të IOSCO-s për zhvillimin e manualit të zbatueshmërisë

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave, IOCSO, në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Armenisë organizoi më 29-31 maj në Yerevan, Armeni, programin e asistencës teknike për zhvillimin e manualit të zbatueshmërisë.



Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave, IOCSO, në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Armenisë organizoi më 29-31 maj në Yerevan, Armeni, programin e asistencës teknike për zhvillimin e manualit të zbatueshmërisë.

Qëllimi i këtij projekti ishte zhvillimi i manualit të zbatueshmërisë në mënyrë që të përdoret nga anëtarët e projektit në jurisdiksonet e institucioneve të tyre. Pjesëmarrësit ishin nga vende të ndryshme si Shqipëria, Maqedonia, Ukraina, Kroacia dhe Armenia, të cilët diskutuan në këtë fazë të parë, ndërtimin e një draftmanuali për zbatueshmërinë. Mes çështjeve kryesore të trajtuara ishin:

- Prezantimi i draft manualit, qëllimi dhe pikat kryesore;
- Qasja mbi zbatueshmërinë dhe fuqinë e sanksioneve, duke sjell shembuj konkret të juridiksioneve të ndryshme. U prezantua qasja e draft manualit për këtë pikë. Gjithashtu u zhvilluan diskutime në grup për sfidat e zbatueshmërisë dhe të fuqisë së sanksioneve në zhvillimin ekonomik të vendit;
- Kryerja e investigimeve (inspektimeve). Procedura e ndjekur në kryerjen e investigimeve, mënyra e marrjes së informacionit, mënyra e përzgjedhjes së çështjeve sipas prioritetit, diskutime në grup se si procedohej në juridiksionin e anëtarëve të vendeve pjesëmarrëse dhe përputhja me drfat manualin. Gjithashtu u diskutua çështja e publikimit dhe e konfidencialitetit, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve gjatë procesit të investigimit, etj.

- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me vullnetin e palëve, procedura e ndjekur, bazat për të arritur në zgjidhjen me marrëveshje, çfarë ndodh nëse nuk arrihet marrëveshja, etj.

Pas çdo teme që trajtohej gjatë projektit, zhvilloheshin diskutime në grup mbi mënyrën se si procedohej në juridiksionin e secilit vend pjesëmarrës dhe më pas prezantoheshin për të bërë diferencimet nëse kishte, ose ngjashmëritë ndërmjet legjislacioneve të vendeve të ndryshme.

## Konferenca e 11-të ndërkombëtare mbi të ardhmen në sigurime

Në datën 23 maj 2019 në Bukuresht, Rumani u mbajt konferenca e 11-të ndërkombëtare mbi të ardhmen në sigurime, e organizuar nga Federata Evropiane e Siguruesve dhe Risiguruesve. Larmia e temave të diskutimit në këtë konferencë trajtuan çështje apo problematika që lidhen me sigurimet, siç janë:

- Rreziqet teknologjike dhe mbrojtja prej tyre;
- Rreziqet nga katastrofat natyrore;
- Përshtatja e legjislacionit për të ardhmen e sigurimeve.

Përsa i përket rreziqeve teknologjike, u diskutua se ekziston problematika e mospasjes së të dhënave të mjaftueshme historike për këto lloj rreziqesh, gjë që çon në pamundësi për t'i çmuar apo përlllogaritur në mënyrë të saktë këto rreziqe.

Lidhur me rreziqet nga katastrofat natyrore, vende të ndryshme kanë skema apo përfshirje në masë të ndryshme të qeverive në skemat e sigurimit të katastrofave natyrore, por ndërkohë identifikohet nevoja e përfshirjes së sektorit të sigurimeve kundrejt mbrojtjes së ambientit, pasi ndryshimet e vazhdueshme klimaterike po çojnë në rritje shqetësuese kryesisht të ndikimit, por dhe frekuencave të ndodhjes së katastrofave natyrore. Kjo gjë dëmton gjithashtu interesat e shoqërive të sigurimit, dhe si shkaktarë kryesorë u identifikua ndotja e ambientit nga lëndët djegëse, kryesisht qymyri dhe hidrokarburet.

Në përfundim të konferencës u diskutua mbi nevojat për ndryshime dhe përshtatje të vazhdueshme të legjislacioneve për sigurimet, me qëllim përshtatshmërinë e tyre me ndryshimet e së ardhmes në sigurime, kjo me qëllim jo vetëm forcimin e rolit mbikëqyrës të rregullatorëve, por edhe rritjen e stabilitetit financiar të tregut të sigurimeve në mbarë botën.

Në datën 23 maj 2019 në Bukuresht, Rumani u mbajt konferenca e 11-të ndërkombëtare mbi të ardhmen në sigurime, e organizuar nga Federata Evropiane e Siguruesve dhe Risiguruesve.

## Vite të rëndësishme përpara për IAIS

Fjala hyrëse e Jonathan Dixon, Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) në seminarin "Progres" të zhvilluar në 28 shkurt 2019. Seminari është bërë në vitin kur IAIS mbush 25 vite nga krijimi. Gjatë kësaj periudhe IAIS është shndërruar në organizmin global të përcaktimit të standardeve për mbikëqyrjen e sigurimeve dhe, duke bashkëpunuar me grupet e interesit, ka ndërtuar një komunitet global për diskutimin e sfidave dhe mundësive për mbikëqyrësit e sigurimeve dhe industrinë e sigurimeve.

(pjesa e parë, me shkurtime e redaktime)

Viti 2019 shënon një arritje të rëndësishme - ne finalizuam fazën e zhvillimit të axhendës së reformës pas krizës dhe ecëm drejt planit tonë të ardhshëm strategjik 5-vjeçar.

Si mbikëqyrës, mandati ynë kryesor është mbrojtja e të siguruarve dhe stabiliteti financiar. Gjithnjë e më shumë mbikëqyrësit e sigurimeve po përfshihen në debate të rëndësishme shoqërore. Njohja e kësaj tendence është pasqyruar edhe në zhvillimin e planit tonë strategjik.

Nga përvoja ime personale, si ish kreu i mbikëqyrjes së sigurimeve në Afrikën e Jugut, mund të flas për sfidën e balancimit të detyrave/mandateve. Në autoritetet e vendeve që janë në fazën e zhvillimit, nëse zhvillimi dhe rritja nuk është e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, kjo kërcënon stabilitetin financiar dhe mbrojtjen e policëmbajtësve. Krijimi i një kuadri mbikëqyrës për të trajtuar hendekun e mbrojtjes është një domosdoshmëri, dhe jo një çështje për t'u debatuar.

### 2019 dhe më gjerë

Duke folur për specifikat e Planit tonë të ri Strategjik, ne kemi pranuar nevojën për t'u riorientuar dhe për të ridimensionuar objektivat. Për ta ilustruar këtë, më lejoni të përqendrohemi në tre mesazhe:

#### 1. Finalizimi i reformave pas krizës

Së pari, sfida jonë e menjëhershme është të finalizojmë pjesën tonë të axhendës së reformave pas krizës, duke pranuar se stabiliteti financiar është një kusht i domosdoshëm për mbrojtjen efektive të policëmbajtësve. Kjo axhendë përfshin Standardet e Kapitalin në Sigurime (ICS – Insurance Capital Standards) dhe kuadrin tërësor për zbutjen e rrezikut sistematik.

**Për komponentët cilësorë të ComFrame**, pothuajse i kemi arritur. Aktualisht po përpunohen standardet e propozuara, bazuar në komentet e marra, përpara finalizimit në nëntor. Tani vëmendja jonë është në mbështetjen e zbatimit të këtyre standardeve cilësore, duke filluar që prej vitit 2020 e më tej.

Viti 2019 shënon një arritje të rëndësishme, ne finalizuam fazën e zhvillimit të axhendës së reformës pas krizës dhe ecëm drejt planit tonë të ardhshëm strategjik 5-vjeçar.



**Në komponentin sasior të ComFrame** – ose standardet globale ICS vazhdon puna intensive për hartimin dhe testimin e tyre në terren. Ne po përpunojmë disa detaje teknike përpara fillimit të testimit në terren. Ky testim do të ndihmojë në marrjen e vendimeve tona përfundimtare, deri në hartimin e ICS Version 2.0 për periudhën 5-vjeçare të monitorimit.

Fokusi ynë do të kalojë tek përgatitjet për këtë periudhë monitorimi, duke përfshirë raportimin konfidencial në kolegjet mbikëqyrëse. Ne do të komunikojmë në vazhdimësi për këtë, por ka disa gjëra për t'u theksuar:

- Gjatë fazës së monitorimit ne do të shqyrtojmë përshtatshmërinë e ICS-ve të ndërtuara, dobinë e tyre dhe si përdoren ato si mjet për të ndihmuar mbikëqyrësit për të bërë punën e tyre më të mirë. Kjo do të përfshijë reagime praktike nga mbikëqyrësit - por po aq e rëndësishme do të jetë përfshirja e reagimeve nga IAIG-s për sfidat me zbatimin e ICS apo pasojat mbi pjesë të biznesit, duke përfshirë edhe ato afatgjata;
- Në fund të periudhës së monitorimit do të kemi arritur një Standard për Kapitalin në Sigurime, ICS globale, me objektiv mbikëqyrjen e IAIG-s në nivel global. Për të qenë i qartë, objektivi nuk është rritja e nivelit të përgjithshëm të kapitalit në sektorin e sigurimeve - dhe kalibrimi ynë i ICS do të përshtatet në përputhje me rrethanat;
- Së fundi, gjatë periudhës së monitorimit, ne do të kemi një diskutim të rëndësishëm brenda IAIS rreth zbatimit të kësaj ICS të vetme - dhe në veçanti, kriteret për vlerësimin nëse Metoda e Agregimit që po zhvillohet nga SHBA jep rezultate të krahasueshme për ICS, si edhe për një qasje të barazvlefshme në zbatimin e ICS.

Në kuadrin e përgjithshëm kemi bërë përparim të mirë dhe komentet që morëm gjatë periudhës së konsultimit kanë qenë inkurajuese. Shumë nga komentet përkrahën drejtimin e përgjithshëm dhe kërkuan qartësi të mëtejshme në fushat, që edhe ne i kishim identifikuar si fusha ku nevojitej zhvillim i mëtejshëm. Ne kemi tri rrjedha kryesore të punës për zhvillim:

- Masat parandaluese të politikës dhe kompetencat mbikëqyrëse të ndërhyrjes;
- Kuadri global i monitorimit (vlerësimi individual dhe sektorial);
- Qasjen ndaj vlerësimit të fuqishëm të zbatimit.

Ne do të japim një përditësim në qershor në Seminarin tonë Global, pasuar nga konsultimet publike mbi propozimet e hollësishme.

## JOURNAL OF RISK MANAGEMENT IN FINANCIAL INSTITUTIONS


Volumi 12, nr.2, përmban këto shkrime kryesore:

- Evolucionit i kuadrit të Bazelit: A jemi kthyer atje ku e nisëm?  
*(The evolution of the Basel framework: Are we back to where we started?)*
- Mangësitë e modeleve në menaxhimin e rrezikut të vendit  
*(The shortcoming of models in country risk management)*
- 14 sfidat e sotme më të mëdha për manaxherët e rrezikut  
*(The top 14 challenges for today's model risk managers)*

## GLOBAL RISK REGULATOR

Volumi 17, maj 2019 përmban këto shkrime kryesore:

- Autoriteti i Sjelljes Financiare në Londër (FCA) sinjalizon kthimin tek qasja e bazuar në parimet pas Brexit  
*(FCA signals return to principles-based approach post Brexit)*
- Rekomandime për të bërë Basel III të funksionojë për ekonomitë e vendeve në zhvillim  
*(Recommendations to make Basel III work for developing economies)*
- Kultura në shërbimet financiare u shndërrua në një çështje kryesore rregulatore dhe politike pas krizës financiare. Ndërkohë që rregullatorët po eksplorojnë qasje të reja rreth interpretimit të sjelljes, kjo mund edhe të krijojë disa pasoja të padëshirueshme  
*(Culture in financial services became a key regulatory and political issue following the financial crisis with regulators exploring new approaches around interpreting conduct, but this could create some unintended consequences)*



## **Bullgari, FSC po punon për skemën Bonus-Malus**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare në Bullgari (FSC) po punon për të vënë në zbatim skemën *Bonus-Malus* për sigurimin MTPL. Kjo skemë, e ngjashme me ato që aplikohen aktualisht në Evropë, do të ndikojë në çmimet e policave të sigurimit në varësi të sjelljes së drejtuesit të mjetit.

Skema shpërblen drejtuesit e përgjegjshëm me çmime më të ulëta të primeve të sigurimit, nëse ata nuk bëjnë aksidente për një periudhë të caktuar kohore. Në anën tjetër, drejtuesit që shkaktojnë aksidente do të kenë një tarifë më të lartë të primit të sigurimit. Aktualisht, disa shoqëri sigurimi në Bullgari e aplikojnë skemën *Bonus-Malus* në rastet e policave MTPL, por tani sistemi pritet të vendoset për të gjithë tregun.

## **Kosovë**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, primet e shkruara bruto për tre muajt e parë të vitit 2019 arritën në 22.3 milionë euro. Tregu i sigurimeve është rritur me 4.24%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 21.4 milionë euro, me një rritje prej 3.4%. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 900 mijë euro.

## **Kroaci**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të Byrosë Kroate të Sigurimeve, në tre muajt e parë të vitit 2019 primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Kroaci arritën në 2.93 miliardë kuna (HRK, monedha vendase) ose 396 milionë euro, me një rritje prej 5.97%. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës ishin 2.1 miliardë kuna, me një rritje prej 10.78%, ndërkohë që primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës ishin 835.5 milionë kuna, me një rënie prej 4.47%.

## Kroaci, HANFA krijon “Laboratorin e Inovacionit”

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Agjencia e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare në Kroaci (HANFA) ka krijuar “Laboratorin e Inovacionit”, një ekip i specializuar, i dedikuar për çështjet e inovacionit financiar në mbikëqyrje – FinTech, InsurTech, RegTech. Ekipi i ekspertëve do të japë këshilla, udhëzime dhe mbështetje me karakter informatik për strukturat e tjera të rregullatorit.

Sipas HANFA-s, objektivat kryesore të “Laboratorit të Inovacionit” janë: mbështetja e zhvillimit të projekteve inovative, reduktimi i kohës së nevojshme për projekte të tilla për t’u zbatuar në treg, thjeshtimi i komunikimit të brendshëm për të vendosur zgjidhjet teknologjike në funksion të realitetit financiar. Presidenti i Bordit Drejtues të HANFA-s, Ante Zigman u shpreh se “...krijimi i Laboratorit të Inovacionit është pjesë e përpjekjeve tona për t’iu përshtatur zhvillimeve të fundit. Zgjidhjet teknologjike për industrinë financiare po evoluojnë me një shpejtësi shumë të madhe. Kjo do të thotë se rregullatorët duhet të jenë po aq të shpejtë dhe fleksibël për implementimin e tyre.”

## Mali i Zi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Malin e Zi, primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve për tre muajt e parë të vitit 2019 arritën në 22.1 milionë euro, me një rritje prej 20.2%. Primet e shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës arritën në 18.7 milionë euro, me një rritje prej 20.8%, ndërsa primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 3.4 milionë euro, me një rritje prej 17.2%.



---

---

## AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)